



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 38-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29. 10. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Latif Ramadani DBF
3. Merita Bytyqi, DSH

4. Bekim Shabani DEZH
5. Visar Kozhani zyrtar i lart financiar
6. Kimete Jashanica OSCE
7. Dhe te tjerë prezent

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakti nga mbledhja e 37-të e Kuvendit
2. Raporti i shpenzimeve Janar-Shtator 2020
3. Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr. 110-623 i datës 26.09. 2008
4. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, kërkoj që të jetë edhe një pikë shtesë;

-Raporti i auditorit të mbrendshëm dhe plani i veprimit .

Latif Ramadani, tha se me kërkesë të kryetarit do të jetë edhe një pikë shtesë ku kemi një memorandum bashkëpunimi me disa komuna për ndarje të mjeteve financiare.

Lulzim Rustemi, edhe ne si grup i PDK-së kemi një propozim të jetë një pikë për gjendjen në arsim në komunën e Lipjanit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se e qes në votim pikat e propozuara nga Kryetari drejtori.

Pastaj u konstatua se Kuvendi me 30 për kaloi këto pika.

Pika 6-të Informatë nga DKA për gjendjen në arsim në Komunën e Lipjanit.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 13 vota për, 15 kundër dhe 2 apstenime nuk kalon këtë Informatë.

Meqë diskutime tjera rreth rendit të ditës nuk pati Kryesuesi e vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 29 votat për, aprovoi rendin e ditës.

Pastaj u kalua në pyetje e anëtarëve të Kuvendit.

Lulzim Rustemi, kam një kërkesë dhe dy pyetje, kërkesa ka të bëjë për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën "Shefki Salihu" pasi që në atë rrugë vozitet me shpejtësi të madhe.

Pyetja e parë ka të bëjë për DSHP-në, lidhur me ndriqimin publik në rrugën Lipjan-Magurë ku ka ankesë të fshatit Hallaq i Vogël pasi që po jesis disa rrugë publike pa u përfshi në këtë projekt.

Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë për fshatin Grackë ku është ndriqimi publik me trotuarë pse nuk është përfshi në këtë fshat trotuari, a do të ketë trotuar a jo?

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë kam disa pyetje e para ka të bëjë me mamogramin në QKMF i cili është jashtë funksionit a pritet që të funksionalizohet. Po ashtu do të ishte mirë që të rritet numri i radiologëve dhe ultraziologëve në QKMF. Ndërsa pyetja e fundit ka të bëjë me konkursin e fundit në arsim çka ndodhi me atë konkurs që një person pranohet pa qenë hiq në test.

Albulena Kelmendi, kam një kërkesë të banorëve të fshatit Glllogovc të rrugës me emrin “Ruga e Vogël” për vendosjen e policëve të shtrirë. Po ashtu gjendja me dezinfektues nuk është e mirë e në veçanti në shkollën ku punoj unë nuk kemi që disa ditë dezinfektues.

Rastet me COVIC-19 çdo vit po rriten dhe neve nxënësit në shkollë po na vijnë me simptoma pasi që ata po shkojnë po kontrollohen dhe doktorët po ju garantojnë se nuk e kanë virusin e si mund ta dijnë ata doktor pa u bërë testet.

Egzona Bytyqi, unë deshta ta ngris një shqetësim timin për qytezën e Magurës ku aty ju vu zjarri Xhamisë qindra vjeçare nga emigrantët. Ajo çka po kërkoj nga ky Kuvend të solidarizohemi me kërkesën e atyre banorëve, po ashtu me këtë çështje do të duhej edhe në Kuvendin e Kosovës. Pasi që sot është djegur një Xhami nesër mund të digjet një pronë private dhe ne nuk mund të heshtim.

Në komunën tonë ka filluar procesi i vaksionimit dhe kjo nuk është publikuar askund në faqen e komunës ku do të njoftoheshin qytetarët dhe të përgatiten psikikisht pasi në teren po mendojnë se është vaksina kundër COVID-19 po hezitojnë me i vaksionu fëmijët. E kam një propozim pasi që në komunën tonë kanë me u vaksionu një numër i madh i nxënësve. E ne në teren e kena vetëm një ekip një mjek dhe dy motra.

Unë kam një propozim që t'i vaksinojmë secilin fëmijë në territorin e vetë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, shumë e drejtë qendra e azilit e ngritur që sot po i vuajnë pasojat banorët e Magurës. Edhe unë jamë solidarizu me banorët e Magurës përmes petitionit por edhe publikisht nëpër media. Një qendër e azilit nuk është e lehtë me qenë në mes të fshatit por ne së bashku duhet me u solidarizu me brengat e atyre banorëve. Vaksionimi pajtohem që të decentralizohet në QKMF dhe në AMF nëse ka kapacitete të mjeftueshme. Dhe kisha kërku prej drejtoreshës që të bëjë thirrje që prindërit t'i vaksinojnë fëmijët e tyre. Ndërsa sa i përket vërtetimit të nxënësve unë nuk e di a munden me dhënë doktorët apo jo.

Sa i përket dezinfektuesve nëpër shkolla në Gjimnazin “Ulpiana” dje janë dërguar 250 dezinfektues, ndërsa ka pas edhe në shkolla tjera por secili prej arsimtarëve në shkollë është ose kujdestar i ditës ose kujdestar i klasës dhe ka përgjegjësi me u kujdes se si po shfrytëzohen ata dezinfektues. Dhe është e pa mundur me u ble nga 200 dezinfektues nëse nuk kujdesemi të gjithë së bashku.

Sa i përket policëve të shtrirë në rrugë ne kemi pas rast ku në dy fshatra janë vendos dhe më vonë qytetarët e kanë hjekë ato. Por nëse konstatojnë policia dhe inspektorët e trafikut se duhet me u vendos ne do t'i vendosim.

Te rruga rreth lumit Konjuh do të adresoj si të mundshme për vendosjen e policve të shtrirë.

Sa i përket listës së arsimtarëve të publikuar aty ka ndodh tri gabime teknike dhe nuk ka pasë asnjë pagesë financiare e nuk ka kalu as afati ankimimit dhe ne e kemi anuluar atë konkurs. Dhe ajo është tërheqë pasi që ne jemi njerëz dhe gabojmë. Është publiku lista e aplikantve e jo lista e të pranuarve dhe unë e kam dërgu në komision disiplinor të gjithë komisionin. Trotuari në Grackë nuk është zhvillu në mungesë të mjeteve por në fazat tjera do të shihet mundësia e trotuarit në Grackë.

Sa i përket ndriçimit publik nga Lipjani deri në Magurë do të jetë të gjitha rrugët publike më të frekuentuara të ndriçuara.

Sa i përket memografisë dhe numrit të radiologëve nuk e di.

Qe 7 vite në QKMF nuk kam shpallur asnjë konkurs përveç se për mjek pasi që mjekët më së shumti po i duhen këtij vendi. Dhe çdo të diplomuar në mjekësi jemi përpjekur me sistemu dhe do të vazhdojmë me i sistemu.

Raporti për kokë banori me mjek në Lipjan është më i miri në Kosovë. Kemi pas testime të stafit të mësimdhënësve dhe nxënësve dhe po përgatitemi edhe për fazën e dytë që pritet të vijë në vjeshtë. Dhe ne duhet të përgatitemi për qfardo sfide që do të na vjen.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne po i zbulojmë padrejtësitë që po ju bëhen qytetarëve. Aty ka qenë një listë ku një person i cili nuk ka konkuru fare dhe i ka dalë emri në listë se është i

pranuar. Ky konkurs është anulë për shkak të reagimit të qytetarëve dhe për shkak se është bërë mediatik.

Imri Ahmi, Kryetar i Komunës, tha se Lumja nuk ka dëshirë me ja përmend të kaluarën pasi që e kanë të kaluarën e errët, e sa i përket këtijë konkursi janë organet e drejtësisë që merren me këtë çështje.

Albulena Kelmendi, as unë as kolegët e mi nuk i orjentojnë nxënësit kah keqpërdorimi i aseteve publike. Pasi që të rrezikuar nga COVID-19 jemi të rrezikuar si ne si nxënësit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, përgjegjësia duhet me u adresu se të gjithë dhe unë nuk thash që personeli arsimor po i orjenton nxënësit kah keqpërdorimi. Unë më herët pata takim me drejtorin e gjimnazit dhe dy drejtor tjerë dhe u informova për gjendjen në shkollë.

Hyra Bytyçi, ne e dijmë që muaji tetor është muaji i vetëdijsimit për kancerin e gjirit dhe QKMF ka ofruar shërbime falas të ultrazërit deshta ta pyes drejtoreshën se sa ka qenë numri i të interesuarve për të ju përgjigjur kësaj ftese. Si dhe sa ka qenë numri i të infektuarve të stafit dhe a ka për momentin të infektuar dhe a ka reduktim të stafit. Edhe unë i bashkangjitem kolegës Egzonë për shqetësimin e djegëjes së Xhamisë në fshatin Magurë dhe solidarizohem me banorët e Magurës. Por edhe organet e sigurisë duhet të merren më shumë me këtë çështje.

Bashkim Budakova, kam një pyetje për drejtoratin e arsimit për konkursin për mësimdhënësit rezervë edhe pse u dha një përgjigje por nuk ke adekuate. Këtu u tha që ka ndodh një gabim por kanë qenë 4 lista, konkursi, lista e aplikantëve, lista e testit me shkrim që kanë kaluar 50% dhe lista e të pranuarve dhe kjo me kalu kaq shpejt mua po më duket jo e arsyeshme. Por për këtë do të ishte më mirë të ishte edhe drejtoresha këtu dhe të na shtaronte pak ma qartë. Dhe do të ishte mirë që për këtë të ishte një pikë e veçantë dhe të diskutohet më shumë.

Nazmi Krasniqi, unë edhe më herët e kam bërë një kërkesë në Kuvend por po e përsërisë prap është kërkesë e qytetarëve për rrimërimin dhe emërtimin e rrugëve. Unë jam krenarë për punën që e kam bërë ndoshta ka ndodh edhe te na gabime por ky gabimi i juaj është më i madh.

Edhe unë jam përkrahë qytetarëve të Magurës.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, gabime të tilla kanë ndodh edhe në të kaluarën po ndodhin tash dhe mund të ndodhin edhe në të ardhmen pasi që ne nuk jemi ideal dhe të pa gabueshëm. Sa i përket emërtimit dhe rrimërimin të rrugëve jam në dilemë pasi që kemi telashe dhe janë mbi 200 kërkesa me shkrim për heqje të emërave të cilët nuk janë pajtu.

Ganimete Qeriqi, shpesh herë po e shoh që këtu në këtë sallë po përdoren shprehja policët e shtrirë e të cilën nuk kam mundur ta gjejë gjatë leximit por jam e interesuar t'i pyes gjuhëtarët se si duhet të jetë kjo fjalë ata më kanë spjeguar se duhet të jetë pengesa në rrugë në vend të policëve të shtrirë. Lipjanit i mungon një onkolog dhe unë ju uroj Egzonës dhe drejtoreshës për specializimin.

Argjend Tasholli, kam një kërkesë për drejtorin e inspektionit për varrezat në fshatin Gadime të lagjes Tasholli, Leka, Aliu etj. ku është bërë një deponi e mbeturinave inerte, kërkoj nga inspektoriat të dal në teren dhe ta shikoj gjendjen.

Kërkesa tjetër është për rrimërimin e gurëthyesve me murin mbrojtës pasi që po rrezikohen qytetarët. Ka edhe kërkesa tjera të banorëve të fshatit Gadime. Dhe kërkesa e fundit ka të bëjë me familjen Hajrizi nga fshati Gumnasellë që të paktën të zhavorohet rruga e tyre.

Afrim Miftari, kam për ta ngritur një problem të rrugës regjionale Gadime-Gjilan ku me sa e di unë më herët ka pas me u matë fluksi i veturave dhe aty ka fluks të madh është mirë që ajo rrugë të devijohet dhe mos të jetë në mes të fshatit, pasi që shpejtësia e lëvizjes po jetë e pa kontrolluar dhe mund të rrezikohen qytetarët.

Lulzim Rrustemi, është një skandal por për këtë temë duhet të flitet në një pikë të veçantë sa i përket arsimit në Lipjan. Dhe ne do ta propozojmë në një seancë tjetër temën rrimërimin në Lipjan.

Arben Salihu, kam një pyetje për Drejtoratin e Shërbimeve Publike ku jam dëshmitarë vetë që distanca fizike në autobus nuk po mbahet fare. Dhe kërkoj nga ky drejtorat që të merret më shumë me këtë çështje.

Çështja e dytë ka të bëjë me afishet e letrës që po shpërndahen nga bizneset e të cilave ju ka kalu koha është mirë që të bëhet një Rregullore siç e kanë komunat tjera që të ju ndalohet kjo çështje.

Nazmi Krasniqi, sa i përket arsimit sot ki drejtor të shkollave të cilët nuk rrinë kurrë në shkollë por tërë ditën e kalojnë jashtë shkollës.

Merita Bytyqi, ne kemi pas njoftim për ultrazë falas siç e përmendi asambleistja dhe ftesës ju kanë përgjigjë ofër 60 gra. Sa i përket stafit mjekësorë kemi pas 10 mjekë të infektuar, 11 infermier dhe 10 persona kontakti e për momentin nuk e kemi asnjë të infektuar. Por ne e kemi bërë të gjitha përgatitjet me staf të nevojshëm por edhe me staf shtesë të mjekëve privat nëse keqësohet situata. Mamografinë e kemi jashtë përdorimit për shkak të një defekti. E sa i përket radiologut e kemi një por jemi me fat që e kemi pasi që QKMF-ve nuk ju ka lejuar që të kenë radiolog. E vlersoj propozimin e Dr. Egzonës për vaksionim të secilit në vendin e vetë dhe do ta shikojmë këtë ropozim.

Nuk besoj që ka ndonjë mjekë që ju thotë nxënësve e ki apo nuk e ki covidin, nëse i kanë simptomat ata i udhëzojnë për vetë izolim. Dhe asnjë mjekë nuk shkon me diagnozë përfundimtare pa u vertetu me analiza shtesë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket rrugës Gadime-Gjilan ajo ka kalu komplet në menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Unë mendoj që nuk ka fluks të madh të veturav por duhet me gjetë mundësinë që në të ardhmen të gjindet një alternativ që ajo rrugë të jetë në mesë të Gadimes dhe Smallushës. Sa i përket rrugëve ne e kemi agjendën tonë dhe atë do ta implementojmë. Sa i përket konkursit nuk e dijë çfarë skandali mundet me pas kur ska pas kurrfar efekti financiar dhe askush nuk është pranuar në punë pasi që ai konkurs është anuluar para afatit ankimor.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 37-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 37-të të Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 37-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i shpenzimeve Janar-Shtator 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, shpenzimi i buxhetit ka pas telashet e veta për shkak të situatës në të cilën po gjindemi por kjo është dashtë të jetë shtytje për këta muaj në vazhdim që të ketë rritje, e të arrihet te një shpenzim i kënaqshëm i yni. Në përgjithësi kemi një buxhet të

shfrytëzuar jo mirë. Te investimet kapitale është një shumë e mjeteve jo e mirë e shfrytëzuar. Po ashtu edhe te granti qeveritar kemi shpenzim të vogël, ashtu edhe te të hyrat vetanake të bartura. Nuk e kemi më mirë punën as te donacionet por as te bujqësia, shëndetësia, kulturë, rini sport etj.

Te karburantet është një shumë e madhe e shpenzuar . Dhe për fund kam një pyetje te shërbimet tjera kontraktuale për cilat shërbime bëhet fjalë.

Albulena Kelmendi, parafolësi e bënë elaborimin mbreëlënës duke hyrë nëpër secilën kategori. Ajo çka ne e kemi vërejt është dinamika e ulët e shpenzimeve ku kemi projekte që kanë filluar tash vonë e të cilat kanë shifër zero të shpenzimit.

Shpenzimi i buxhetit prej 73% është shifër e ulët dhe shqetësuese.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr. 110-623 i datës 26.09. 2008

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani, ne si grup i LDK-se e kemi shqyrtu propozim vendimin për ndryshimin e Statutit të Komunës, pasi që kjo është e bazuar në Ligj dhe komuna e jonë ka nevojë për harmonizim pasi që disa fshatra kanë kaluar në kompetencë të komunës së Graçanicës. Ne mendojmë se ky plotësim ndryshim i Statutit është i nevojshëm dhe si të tillë e përkrahim.

Albulena Kelmendi, ne në KPF e kemi dhënë një rekomandim që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës së Kuvendit, nuk e dijë pse Kryesuesi nuk e potencoj. Qëndrimi i ynë si subjekt qysh ka qenë më herët kundër, do të jetë edhe tash kundër këtij propozimi. Kur është bërë decentralizimi komuna jonë nuk është pyetur e as një komunë tjetër. Si asambleiste dhe si qytetare jam kundër që këto fshatra të largohen nga Statuti i komunës. Lenë të qëndojnë këto fshatra kështu siç janë. Dhe këtyre qytetarëve të ju ofrohen shërbime ashtu siç e meritojnë.

Lulzim Rrustemi, vullneti ynë nuk është për ndryshim dhe ne nuk e kemi bërë këtë ndryshim edhe kur kemi qenë në pushtet. Leta diskuton Ligjin Kuvendi i Kosovës pasi që qytetarëve të Lipjanit në komunën e Graçanicës ju bëhet një pritje shumë e egër, ku asnjë shërbim nuk mund ta kryejnë si qytetarë të Kosovës. Vullneti i qytetarëve të Lipjanit nuk ka qenë që të shkojnë me Graçanicë. Dhe vullneti ynë nuk është për këtë ndarje dhe ne nuk do të votojmë për këtë.

Afrim Miftari, ne edhe në KPF e kemi diskutu këtë propozim dhe kemi dhënë qëndrimet tona. Gjendja faktike është krejt ndryshe me Statutin e vjetër. Gjendja në teren është krejt tjetër pasi që qytetarët e këtyre 8 fshatrave shërbimet i marrin në komunën e Graçanicës. Na jemi për këto ndryshime.

Ukë Kryeziu, kjo çështje është diskutuar edhe më herët dhe me sa e dijë unë komuna e Lipjanit nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje. Kërkoj nga Kryetari pasi që është kryetar i asociacionit të komunave të Kosovës ta ngrit këtë çështje në nivel të kryetarëve të komunave për vendosjen e emrave të fshatrave pasi që nuk dihen se cilat janë. Qytetarët shqipëtarë të cilët e kryejnë ndonjë shërbim në komunën e Graçanicës trajtohen në mënyrën më të keqe të mundshme. Ku për një fletë poseduese kam prit një muaj. Ky shqetësim duhet të ngritet në nivel qëndror. Kam një propozim që niveli qëndror të merrë një vendim që fleta poseduese të mund të nxjerret në cilëndo komunë ashtu siç nxerren certifikatat.

Bekim Shabani, ne kemi kërkesë vetëm për harmonizimin me Ligjin pasi që edhe faktikisht edhe juridikisht këto edhe me Statut menaxhohen me komunën e Graçanicës. E kam para vetës një marrëveshje e vitit 2010 e nënshkruar nga ish kryetari i komunës.

Daut Azemi, është e drejtë e secilit të votoj siç të doj por e vërteta duhet të dal në shesh.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi tha se ndryshimet statutare bëhen me 2/3 e votave pastaj e vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 15 vota për, 14 kundër nuk aprovoi këtë:

Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr. 110-623 i datës 26.09. 2008

IV

Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim rregullore dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 votat për aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E
PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Neni 1
Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Lipjanit cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësité bujqësore të parcelave----- 0.00 %
- Për njësité bujqësore të objekteve----- 0.15 %
- Për njësité pyjore të parcelave----- 0.15 %
- Për njësité rezidenciale të parcelave----- 0.15 %
- Për njësité rezidenciale të objekteve----- 0.15 %
- Për njësité komerciale të parcelave----- 0.30 %
- Për njësité komerciale të objekteve----- 0.30 %
- Për njësité industriale të parcelave----- 0.20 %
- Për njësité industriale të objekteve----- 0.20 %

Neni 2
Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2021.

Shtesë; Vendimi.

V

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, kam një pyetje se për cilën qendër bëhet fjalë për në Prishtinë apo për qendrën në Lipjan.

Latif Ramadani, kjo ka të bëjë për qendrën në Prishtinë. Ndërsa ajo në Lipjan është kompetencë e Minisrisë së Punëve të Brendshme.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim rregullorë dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 votat për aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 3000,00 € (tre mijë euro), për ta mbështetur financiarisht mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores, objekti i së cilës gjendet në Komunën e Prishtinës dhe ju shërben gjashtë Komunave nënshkruese të këtij Memorandumi në mënyrë që strehimorja të kryejë funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë në të cilën përcaktohet obligimi i komunave të cekura për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të strehimores për periudhë tre (3) vjeqare 2020,2021dhe 2022 dhe konkretisht kontributi financiar i Komunës së Lipjanit për vitin 2020 për strehimoren do të jetë 3000,00 € (tre mijë euro).

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfere të planifikuara për vitin 2020 .

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,⁴⁵

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**

